



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 948/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohen** programet e studimit të Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë”, për periudhën tre (3) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2025:
 1. *Biznes dhe Menaxhment, BA*, 180 ECTS, me specializimi në; 1. *Banka Financa dhe Kontabilitet dhe 2. Menaxhment dhe Ndërmarrësi*, maksimumi 60 studentë për vit akademik,
 2. *Xehetari, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 60 studentë për vit akademik,
 3. *Xehetari, MSc*, 120 ECTS, maksimumi 15 studentë për vit akademik,
 4. *Teknologji, BSc*, 180 ECTS, me specializim në: 1. *Inxhinieri Mjedisore dhe 2. Inxhinieri kimike*, maksimumi 100 studentë për vit akademik,
 5. *Teknologji, MSc*, 120 ECTS, me specializimi në; 1. *Inxhinieri e Mbrojtjes Mjedisore dhe 2. Inxhinieri Kimike*, maksimumi 20 studentë për vit akademik,
 6. *Vendburimet Minerale, MSc*, 120 ECTS, maksimumi 10 studentë për vit akademik,
 7. *Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 100 studentë për vit akademik.
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Universitetit “Isa Boletini” në Mitrovicë” që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Universiteti “Isa Boletini” në Mitrovicë”, që çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit të raportojë dhe arsyetojë në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

1/3

ARSYETIM

Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë" në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për riakreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë;

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Biznes dhe Menaxhment, BA</i> , 180 ECTS, Riakreditim	Bashkim Bellaqa Isa Tahiri Qazim Tmava Filloreta Kunoviku Demiri
2.	<i>Xehetari, BSc</i> , 180 ECTS, Riakreditim	Kemajl Zeqiri Rafet Zeqiri Ahmet Tmava
3.	<i>Xehetari, MSc</i> , 120 ECTS, Riakreditim	Izet Zeqiri Gezim Ibishi
4.	<i>Teknologji, BSc</i> , 180 ECTS, Riakreditim	Mensur Kelmendi Flora Ferati Florent Dobroshi Mehush Aliu
5.	<i>Teknologji, MSc</i> , 180 ECTS, Riakreditim	Sadija Kadriu Milaim Sadiku Ismet Mulliqi Faruk Hajrizi
6.	<i>Vendburimet Minerale, MSc</i> , 120 ECTS, Riakreditim	Sylejman Hyseni Bedri Durmishaj
7.	<i>Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, BSc</i> , 180 ECTS, Riakreditim	Dilaver Salihu Fatos Rexhepi Valdet Gjinovci

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin "Isa Boletini" në Mitrovicë me këtë përbërje: Mikus Dubickis, Dorota Dobija, Alvar Soesoo, Tea Marohnic, Regita Bendikiene, Kyriaki Zinoviadou, Giga Khositashvili, Rebecca Maxwell, Juraj Bogat, Martins Upmacis dhe Cristina Fit. Vizitat janë organizuar në datat: 01.03.2022, 14.03.2022, 25.03.2022, 05.04.2022 dhe 27.04.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

1. Për programin e studimit *Biznes dhe Menaxhment, BA*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht një (1), substancialisht pesë (5) dhe pjesërisht një (1) standard.
2. Për programin e studimit *Xehetari, BSc*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4) dhe substancialisht tri (3) standarde.
3. Për programin e studimit *Xehetari, MSc*, 120 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht dy (2) dhe substancialisht pesë (5) standarde.

4. Për programin *Teknologji, BSc*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht katër (4), substancialisht një (1) dhe pjesërisht dy (2) standarde.
5. Për programin *Teknologji, MSc*, 120 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht tri (3), substancialisht tri (3) dhe pjesërisht një (1) standard.
6. Për programin e studimit, *Vendburimet Minerale, MSc*, 120 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht katër (4) dhe pjesërisht tri (3) standarde.
7. Për programin *Inxhinieri dhe Teknologji Ushqimore, BSc*, 180 ECTS, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: substancialisht shtatë (7) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë" dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit "Isa Boletini" në Mitrovicë"
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë